



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë 21/09/2020

Nga: Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndrëçimit Publik.

Drejtuar: Shoqërisë “ELECTRICAL POWER ENGINEERING” shpk me NUIS K81511012V me adresë: Rruga Teodor Ruzvelt, Pallati Nelsi, Kati I - re, Lagjja Selite, Farkë, Tiranë.

Procedura e prokurimit: Kërkesë për Propozim.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-70163-08-28-2020.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Kabinë elektrike për nyjen e asfalto-betonit” afati: Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 66, Date 08.09.2020.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara si më poshtë:

1. Operatori ekonomik “EDICO GROUP” shpk me NUIS L82118039C me ofertë ekonomike **5.724.216** (pesë milion e shtatëqind e njëzetë e katër mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë pa tvsh.
2. Operatori ekonomik “ELECTRICAL POWER ENGINEERING” shpk me NUIS K81511012V me ofertë ekonomike **5.174.700** (pesë milion e njëqindë e shtatëdhjetë e katër mijë e shtaëqind) lekë pa tvsh.
3. Operatori ekonomik “I T E GRUP” shpk me NUIS K11323001H me ofertë ekonomike **5.681.920** (pesë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e një mijë e nëntëqind e njëzet) lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “EDICO GROUP” shpk me NUIS L82118039C

Përkatësisht për arsyt e mëposhtme:

- Nuk përmbush pikën 1, shkronja dh, të kriterëve të veçanta të kualifikimit ku është parashikuar se “Ofertuesi duhet të dorëzojë: dh.Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë, që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.” pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e kësaj pike.
- Nuk përmbush pikën 2.2.1 të kapacitetit ekonomik dhe financiar ku parashikohet se “ Ofertuesi duhet të dorëzojë: 1.Kopje të çertifikuara të pasqyrave financiare të 2 (dy) viteve të fundit ushtrimore (2018,2019), të konfirmuara nga Dega e Tatim

Taksave si dhe të shoqëruara me Raportin e Auditimit Ligjor, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor,organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.” pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e kësaj pike.

- Nuk përmbush pikën 2.2.2 të kapacitetit ekonomik dhe financiar ku parashikohet se “ *Ofertuesi duhet të dorëzojë: 2. Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 2 (dy) viteve të fundit ushtrimore (2018, 2019) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e së cilës duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit përkatësisht: 5.743.170 (pesë milion e shtatëqind e dyzetë e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë) lekë pa tvsh.*” pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e kësaj pike.
- Nuk përmbush pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik ku parashikohet se “*Furnizime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, në vlerën prej jo më pak se 40% të fondit limit të vënë në dispozicion përkatësisht: 2.297.268 (dy milion e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.*”

Këto furnizime të ngjashme do të vërtetohen me dokumentacionin si mëposhtë:

a. Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me ente publike, operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur vërtetimin e lëshuar nga enti publik për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate dhe faturat tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

OSE

b. Kur furnizim i ngjashëm është realizuar me subjekte private operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur fatura tatimore shitje, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara”

pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e kësaj pike.

- Nuk përmbush pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik ku parashikohet se “*Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar për mallrat, objekt prokurimi si mëposhtë:*

- *Transformator*
- *Çela Linje dhe Mbrojtje Transformatori*
- *Kabëll TM 1x185*
- *Kabëll TU CU sipas seksioneve*
- *Panel elektrik*

Në rast se paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja ndërmjet distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.” pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e kësaj pike.

- Nuk përmbush pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik ku parashikohet se “ *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratën e konformitetit CE për mallrat objekt prokurimi si mëposhtë:*

- Transformator
- Çela Linje dhe Mbrojtje Transformatori
- Kabëll TM 1x185
- Kabëll TU CU sipas seksioneve
- Panel elektrik

pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e kësaj pike.

- Nuk përmbush pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik ku parashikohet se “Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatën e ndërtimit të panelit (Panel Builder), për të treguar aftësitë e assemblimit të tij.” pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e kësaj pike.
- Nuk përmbush pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik ku parashikohet se “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë garancie për transformatorin, çelat e linjës, çelën e mbrojtjes së transformatorit dhe panelin elektrik, në të cilën të jenë përcaktuar dhe përshkruar qartë të gjithë termat dhe kushtet e garancisë teknike që mbulon ofertuesi, si dhe periudha e garancisë jo më pak se 1 (një) vit nga marrja në dorëzim e mallit, objekt prokurimi. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë).” pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e kësaj pike.
- Nuk përmbush pikën 2.3.8 të kapacitetit teknik ku parashikohet se “Dëshmi për mjetet e transportit, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Kamion me vinç me peshëmbajtje minimumi 2 ton	1	Pronësi ose me qira

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Mjetet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi.

b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për mjetin e deklaruar, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.”

pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e kësaj pike.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik Operatori ekonomik “ELECTRICAL POWER ENGINEERING” shpk me NUIS K11323001H, me adresë Rruga Teodor Ruzvelt, Pallati Nelsi, Kati I - re, Lagjja Selite, Farkë, Tiranë dhe me ofertë ekonomike 5.174.700 (pesë milion e njëqindë e shtatëdhjetë e katër mijë e shtatëqind) lekë pa tvsh, **është identifikuar si ofertë e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Rruga 5 Maji, sigurimin e kontratës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve që nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **5.681.920** (pesë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e një mijë e nëntëqind e njëzet) lekë pa tvsh, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë 11.09.2020.

Ankesa: Nuk ka.